

BACHELOR NË “SHKENCA POLITIKE”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” i njeh studentët me bazat e identifikimit dhe analizimit të çështjeve politike komplekse, formulimit të zgjidhjeve strategjike dhe zbatimit efektiv të tyre. Programi është strukturuar për të zhvilluar aftësitë e mendimit kritik të studentëve duke nxitur autonominë në gjykim. Kurrikula e programit synon aplikimin e njohurive në skenarë të vërtetë politikë, duke përgatitur studentët për role të ndryshme në sektorët publik dhe privat, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

REZULTATET E TË NXËNIT

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët jenë në gjendje të:

- Kuptojnë dhe lidhin teoritë dhe qasjet kyçe: Demonstrjnë një kuptueshmëri të teorisë, literaturës dhe metodologjive themelore nën-fushave kyçe të shkencave politike duke përfshirë qeverisjen, teoritë politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikat krahësuese.
- Zotërojnë metodologjinë e kërkimit dhe aftësitë analitike: Tregojnë aftësi në metodologjitë bazë të kërkimit dhe analizës specifike për shkencat politike. Kjo përfshin aftësinë për të vlerësuar në mënyrë kritike dhe ndërtuar argumente bindëse rreth fenomeneve politike, të komunikuar efektivisht përmes formateve të shkruara dhe të folura.
- Vlerësojnë në mënyrë kritike veprimet dhe motivimet politike: Zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë kritike veprimet dhe motivimet themelore të aktorëve të ndryshëm politikë. Kjo përfshin kuptimin e ndërveprimit kompleks të faktorëve që influencojnë sjelljen dhe proceset e vendimmarrjes politike.
- Kuptojnë vendimmarrjen politike dhe bazën filozofike: Fitojnë një kuptueshmëri të plotë të mënyrës se si individët dhe grupet marrin vendime në kontekste politike. Kjo përfshin një kuptueshmëri të hollësishme të formave të ndryshme të qeverisjes, bazave filozofike të sistemeve të ndryshme politike, ideologjive që formësojnë mendimin politik dhe strukturës dhe funksionimit të partive politike.

PROFILI: ADMINISTRATË PUBLIKE

- Zotërojnë konceptet politike dhe të kornizave të administrimit publik: njohin konceptet, teoritë dhe metodologjitë kyçe në administrimin publik, si edhe kontekstin politik dhe institucional.
- Zhvillojnë aftësi në menaxhimin e burimeve njerëzore: për të menaxhuar efektivisht burimet njerëzore dhe koordinuar një sërë aktiviteteve administrative, duke përfshirë planifikimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive në sektorin publik.
- Zhvillojnë aftësi praktike të administrimit publik, duke përfshirë mënyrën se si funksionojnë drejtuesit e administratës publike dhe ndikimin e vendimeve dhe veprimeve të tyre në shoqëri.

PROFILI: STUDIME EUROPIANE

- Kuptojnë proceset e integritetit dhe vendimmarrjes së BE.
- Vlerësojnë në mënyrë kritike, të pavarur dhe i komunikojnë efektivisht çështjet e diskursit publik të BE-së.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- Njohin në thellësi procesin e integritit evropian, duke përfshirë dimensionet e tij ekonomike, politike, institucionale, historike dhe ligjore dhe kuptojnë nivelet e ndryshme të ushtrimit të pushtetit politik brenda BE-së.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Të diplomuarit kanë mundësi të punësohen në sektorë që lidhen me politikën:

- Specialistë në institucione të administratës qendrore dhe lokale.
- Nëpunës i shërbimit diplomatik në ambasada, konsullata dhe misione diplomatike.
- Specialistë, konsulentë dhe koordinatorë projektsh/ programesh në organizata ndërkombëtare dhe OJF.
- Gazetar/analist i çështjeve politike/korrespondent i lajmeve.
- Asistent kërkues dhe analist në kompani kërkimore, *think tanks* ose institucione akademike.
- Konsulent politik për grupe politike ose organizata.
- Menaxher fushatash, specialist i marrëdhënieve me publikun, konsulent politik, shkruar fjalimesh.



BACHELOR "SHKENCA POLITIKE" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/32 ECTS

1	I	1	Hyrje në filozofi	6
2	I	1	Hyrje në sociologji	6
3	I	1	Shkrim akademik + Metoda kërkimi	8
4	I	2	Statistikë	6
5	II	1	Hyrje në ekonomi	6
				32

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/98 ECTS

1	I	2	Hyrje në shkenca politike	8
2	I	2	Hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare	8
3	I	2	Histori bashkëkohore	6
4	II	1	Politikë e krahasuar	6
5	II	2	Teoritë Politike	8
6	II	2	E drejtë kushtetuese	6
7	II	1-2	E drejtë ndërkombëtare publike 1+2	12
8	II	1	Partitë Politike dhe sistemet zgjedhore	6
9	III	1	Hyrje në administrim publik	10
10	II	2	Psikologji Sociale	6
11	III	2	Historia politike e Shqipërisë	8
12	III	1	Komunikim politik	8
13	I	2	E folura në publik	6
				98

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/24 ECTS

PROFIL I			ADMINISTRATË PUBLIKE	
1	III	1	Hyrje në menaxhimin e burimeve njerëzore	6
2	II	2	Psikologji organizative	6
3	III	2	E drejtë administrative	6
4	III	2	Komunikim organizativ	6
5	III	2	Honors Course	6
PROFIL II			STUDIME EUROPIANE	
1	II	2	Historia e Integrimit dhe Institucionet e BE	6
2	III	2	Politikat e BE-së	6
3	III	2	Organizatat ndërkombëtare	6
4	III	1	E drejta e Bashkimit European	6
5	III	2	Honors Course	6
				24

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/20 ECTS

1	I	1	Anglisht	5
2	I	1	Bazat e informatikës	4
3	II	1	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
4	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	5
				20

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	1-2	Punimi i diplomës/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	-----	---	---